



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:021290

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06461851

PPP.nr.15/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj me zyrtaren ligjore Albane Morina, në çështjen përmbartimore të kreditorit R.B.nga fshati K. Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson Avdullah Hoti avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën e borxhit në shumën prej 676.20 euro në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe 124.00 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur me datë 05.01.2024 kundër urdhrin përmbartimor P.nr.837/23 të datës 14.12.2023 i caktuar nga përmbartuesi privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar** prapësimi i debitorit të përmbartimit, Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.837/23 të datës 14.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë **vetëm sa i përket shpenzimeve procedurale** dhe atë i njihen kreditorit shpenzimet vetëm për përpilimin e propozimit për përmbartim në shumën prej 156.00 euro, kurse refuzohet kërkesa për shpenzimet mbi shumën e aprovuar.
- II. MBETET NË FUQI** Urdhri për lejimin e Përmbartimit numër P.nr.837/23 i datës 14.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë sa i përket shumës prej 676.20 euro për shpenzimet e udhëtimit dhe shumës prej 124.00 euro për shpenzimet e procedurës kontestimore, të gjitha këto të njohura sipas aktgjykimit C.nr.699/2021 të datës 25.05.2022.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e kreditorit për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim në shumën prej 156.00 euro dhe shpenzimet për përgjigje në ankesë në shumën prej 156.00 euro.

A r s y e t i m

Përmbaresi privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit R.B. nga fshati K. Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Avdullah Hoti nga Fushë Kosova, ka lëshuar urdhër numër P.nr.837/23 të datës 14.12.2023 me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë/Divizioni Civil C.nr.699/2021 të datës 25.05.2022, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 27.10.2023, i ekzekutueshëm me datën 30.11.2023, i vërtetuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4066/2022.

Me propozimin për përmbarim, kreditori ka kërkuar që të caktohet përmbarimi, ashtu që të detyrohet debitori Komuna e Malishevës/Drejtoria Komunale e Arsimit, që kreditorit në emër të shpenzimeve të udhëtimit t'ia paguaj shumën prej 676.20 €, shpenzimet e procedurës kontestimore në vlerë prej 124.00 euro, shpenzimet për përgjigje në ankesë në shumën prej 156.00 euro, shpenzimet në emër të draftimit të propozimit për përmbarim në shumën prej 156.00 euro dhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 156.00 euro.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit dhe brenda afatit ligjor me datë 05.01.2024, prapësim ka paraqitur debitori.

Në prapësim debitori ka theksuar se e konteston urdhrin për përmbarim nga përmbaresi privat pasi kjo nuk është lejuar konform aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës C.nr.699/21, pasi në bazë të këtij aktgjykimi, janë njohur shpenzimet e palës në procedurë për padi 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore 21.00 euro, ndërsa kreditori i ka shtuar shpenzimet për përmbarim në shumën prej 156.00 euro, dhe për përgjigje në prapësim në shumën prej 156.00 euro e në këtë rast nuk ka pasur fare përgjigje në prapësim.

I ka propozuar gjykatës ta aprovoj prapësimin e komunës së Malishevës si të bazuar dhe urdhrin e përmbaresit privat Irfan I. Kërçagu ta shfuqizoj si të pabazuar sa i përket shpenzimeve procedurale që ka të bëjë te përgjigja në prapësim, si dhe të vlerësohen këto shkresa në bazë të konkluzionit të gjykatës së Apelit të Kosovës, lidhur me shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim me datë 11.01.2024 ka ushtruar i autorizuari i kreditorit i cili i ka propozuar Gjykatës që të vazhdohet me procedurën përmbarimore dhe ta refuzojë prapësimin si të pabazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar dhe atë për propozimin për përmbarim shumën prej 156 euro, shpenzimet për përgjigjen në ankesë në shumën prej 156.00 euro dhe për përgjigjen në prapësim shumën prej 156 euro.

Vlerësimi i gjykatës dhe baza ligjore

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vendosur si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktvendimi ku e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit vetëm sa i përket shpenzimeve procedurale duke ia njohur shpenzimet kreditorit vetëm sa i përket përpilimit të propozimit për përmbarim

në shumën prej 156.00 euro, ndërsa e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e kreditorit për kompensimin e shpenzimeve mbi shumën e aprovuar dhe po ashtu e ka refuzuar kërkesën për përpilimin e parashtresës në emër të përgjigjes në prapësim shumën prej 156.00 euro, dhe kërkesën për shpenzimet për përgjigjen në ankesë në shumën prej 156.00 euro

Lidhur me obligimin që debitori t'ia paguaj kreditorit shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarrim shumën prej 156.00 euro, gjykata është bazuar në rregulloren për tarifatat e avokatëve nr. tarifor 6 për përmbarrim në bazë të titullit përmbarrimor me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël (deri 500.00 euro).

Kurse refuzimi mbi shumën e aprovuar dhe atë për përgjigje në prapësim dhe për përgjigje në ankesë si në pikën -III- të dispozitivit, është refuzuar për shkak se të njëjtat nuk konsiderohen parashtresa në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6.1 të OAK-së, si dhe nenit 2.4 të UA Nr.01/2017 të datës 15.03.2017, për unifikimin e taksave gjyqësore, si dhe pikës 4 të konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, e datës 16-17 mars dhe 26-27 qershor 2023.

Gjykata ka vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të aktgjykimit duke e lënë në fuqi Urdhrin për lejimin e Përmbarrimit numër P.nr.837/23 të datës 14.12.2023 pasi gjeti se prapësimi nuk është i bazuar vetëm sa i përket shumës prej 676.20 euro për shpenzimet e udhëtimit dhe shumës prej 124.00 euro për shpenzime të procedurës kontestimore, të gjitha këto të njohura sipas aktgjykimit C.nr.699/2021 të datës 25.05.2022, nga këto arsye:

Me nenin 21 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) është paraparë që: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Në rastin konkret kreditori ka kërkuar lejimin e propozimit për përmbarrim, sipas dokumentit përmbarrimor dhe gjykata ka vlerësuar se përmbarrimi i lejuar nga ana e Përmbarruesit Privat bazohet në dokumentin përmbarrimor-aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë C.nr.699/21 të datës 25.05.2022, i plotfuqishëm me datë 27.10.2023 i ekzekutueshëm me datën 30.11.2023 dhe i vërtetuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4066/2022, në bazë të të cilit organi përmbarrues edhe e ka zbatuar përmbarrimin, duke u bazuar në nenin 22 paragrafin 1, nën par.1.1. të LPP-së ku përcaktohet se: *“Dokumentet përmbarruese janë: 1.1. vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësor përmbarrues”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, Aktgjykimi në fjalë është dokument përmbarrues, i ekzekutueshëm dhe përbën bazë të ligjshme juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç e parasheh neni 24 par.1 i LPP-së, ku theksohet se: *“vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarrueshëm po që se ka marrë formën e prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushjen vullnetare”*, kurse në dispozitën e nenit 27 të LPP përcaktohet: *“Dokumenti*

përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, e duke u bazuar në shkresat e lëndës, propozimi për përmbarim i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së, pasi që propozimit për përmbarim kreditori i ka bashkangjitur dokumentin origjinal me vulë të ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë.

Andaj, nga arsyet e paraqitura, Gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit e të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Themelore Gjakovë, Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil
PPP.nr.15/24, datë 15.11.2024

Gjyqtarja:
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.